



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 461/1 Prot.

Tiranë, më 19 . 03 . 2026

V E N D I M

Nr. 59 , datë 19 . 03 . 2026

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 62 Regj., datë 26.02.2026¹, të znj. A. B, kundër Qendrës Kombëtare të Kinematografisë, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjinisë”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Referuar ankesës së depozituar pranë KMD-së, tek shpjegimi i fakteve për diskriminimin e pretenduar, subjekti ankues, znj. A. B, pretendon se është diskriminuar nga ana e Qendrës Kombëtare të Kinematografisë (në vijim referuar me akronimin QKK).

Lidhur me pretendimin për diskriminim nga ana e QKK-së, ankuesja shpjegon si më poshtë vijon:

“Subjekti kundrejt të cilit pretendoj diskriminimin është Qendra Kombëtare e Kinematografisë (QKK), përmes Komisionit të Vlerësimit të Projekteve (KVP), në thirrjen për dokumentar të vitit 2025, i cili ka marrë vendimin për përzgjedhjen e projekteve fituese në mbledhjen e datës 03.02.2026, si organi kolegjal vendimmarrës përgjegjës për procesin e vlerësimit dhe përzgjedhjes.

¹ Plotësuar nëpërmjet e-mailit datë 05.03.2026

² Në vijim do t'i referohemi me akronimin: KMD.

Në thirrjen për projekt - dokumentar të vitit 2025, për të cilën aplikova, asnjë nga projektet fituese nuk ishte me autore/regjisore grua. Të 10 (dhjetë) projektet e shpallura fituese janë me autorë/regjisorë burra.

Nga rezultatet e publikuara për thirrje të tjera të QKK-së, në të njëjtën periudhë rezulton se:

- *Në thirrjen për filma të shkurtër është shpallur fituese vetëm 1 (një) grua;*
- *Në thirrjen për projekte të ndryshme filmike është shpallur fituese vetëm 1 (një) grua.*

Ky përfaqësim minimal i grave në projektet fituese, në disa thirrje të njëpasnjëshme, krijon dyshim të arsyeshëm për mundësi të garantimit të barazisë gjinore në procesin e vlerësimit.

Gjithashtu, procesi i përzgjedhjes nuk është shoqëruar me publikimin e pikëzimeve apo elementëve të tjera të transparencës, duke e bërë të pamundur verifikimin e objektivitetit të vendimmarrjes.

Duke qenë se QKK është një institucion publik që shpërndan fonde publike, ka detyrimin të respektojë dhe garantojë parimin e barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit në procesin e përzgjedhjes së projekteve.”

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi:

“1. Të hetojë procesin e përzgjedhjes së projekteve në thirrjen për dokumentar të vitit 2025, si dhe në thirrjet e tjera, në funksion të verifikimit të respektimit të parimit të barazisë gjinore dhe ndalimit të diskriminimit.

2. Të vlerësojë nëse përbërja e Komisionit të Vlerësimit dhe rezultati i procesit përbëjnë elementë të diskriminimit për shkak të gjinisë.

3. Të verifikojë ekzistencën e mundshme të konfliktit të interesit në procesin e vlerësimit, nëse anëtarë të komisionit kanë pasur lidhje profesionale, bashkëpunime të mëparshme apo interesa të tjera me subjektet fituese, në kundërshtim me parimet e paanshmërisë dhe barazisë në shpërndarjen e fondeve publike.

4. Në rast të konstatimit të shkeljes së parimit të mosdiskriminimit ose të parimit të paanshmërisë, të rekomandojë:

- *Rishikimin dhe ribërjen e procesit të vlerësimit për thirrjen për dokumentar të viti 2025;*
- *Marrjen e masave për garantimin e transparencës së plotë të pikëzimeve dhe procesverbalëve;*
- *Hartimin e mekanizmave që sigurojnë përfaqësim dhe trajtim të barabartë gjinor në proceset e ardhshme të përzgjedhjes.”*

Pas regjistrimit të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ajo kishte nevojë për plotësim informacioni, në lidhje me shpjegimet bindëse (apo dokumentacionin provues) lidhur me trajtimin e pabarabartë e të pafavorshëm, të pretenduar nga ana e subjektit ankues.

Për këtë arsye, nëpërmjet e-mailit datë 03.03.2026, nga ana e KMD-së, është proceduar me kërkesën drejtuar ankuses, për plotësimin e informacionit të nevojshëm.

Nëpërmjet e-mailit datë 05.03.2026, subjekti ankues ka dërguar pranë KMD-së, shpjegimet e saj, duke parashtruar ndër të tjera:

- Lidhur me pretendimin për trajtimin e pabarabartë shprehet se *fituesit janë vetëm burra që do rrëfejnë histori burrash. Pozita e pabarabartë nuk është vetëm tek përzgjedhja e diferencuar gjinore, por edhe te historitë që do tregohen, dhe kjo e fundit nuk ka rëndësi vetëm për shoqërinë dhe të tashmen tonë, por edhe për dokumentimin dhe rrëfimin e të vërtetave tona në kohë. Qasja gjinore është e domosdoshme.*
- Lidhur me mungesën e transparencës, përsa i takon rezultatit të njoftuar, shprehet se, është ankuar tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit, pasi pretendon se QKK, nuk i është përgjigjur brenda afatit ligjor.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Komisioneri vlerëson se, vetëm fakti që një person posedon shkaqet e mbrojtura, nuk mjafton për të ngritur një pretendim për diskriminim. Personi i cili pretendon se është diskriminuar për shkaqet e pretenduara, por jo vetëm, duhet të parashtrijë fakte nga të cilat mund të prezumohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë shkakun e mbrojtur.

Ankuesja, me datë 03.02.2026, ka aplikuar në thirrjen për projekt-dokumentar të vitit 2025, shpallur në faqen zyrtare të QKK-së, së bashku me shumë aplikantë të tjerë.

Nëpërmjet emaili-t datë 06.02.2026, ankuesja është njoftuar për rezultatin e projektit të saj, ndër të tjera duke e informuar se: *“Pas përfundimit të mbledhjes dhe procesit të vlerësimit nga Këshilli i Miratimit të Projekteve (KMP), projekti juaj nuk është përzgjedhur për financim në këtë raund. Ditët në vazhdim vendimi do të publikohet në faqen zyrtare të QKK-së...”*.

Nga këqyrja e faqes zyrtare të QKK-së³, rezulton se me datë 10.02.2026, është publikuar shpallja e projekteve fituese për film dokumentar dhe promovim.

Rezulton të jetë publikuar dhe renditja (në rend zbritës) sipas vlerësimit me pike, si më poshtë vijon:

Projekte Film Dokumentar

1. “Tej maleve të kaltër është deti”, regjia E. Ç, shtëpia kinematografike “Artalb Film Productions” u vlerësua me 382 pikë;
2. “Përballë malit”, regjia I. B, shtëpia kinematografike “Ska-Ndal” u vlerësua me 372 pikë;
3. “Regjisori përtej sistemeve-V. P “Për njeriun”, regjia E. M, shtëpia kinematografike “EUROFILM” u vlerësua me 361 pikë;
4. “Gjiganti i fjetur”, regjia B. L, shtëpia kinematografike “Filter Film” u vlerësua me 340 pikë;
5. “Tre jetë në një”, regjia V. L, shtëpia kinematografike “Vasjan Lami” u vlerësua me 326 pikë;
6. “Tomorr”, regjia A. S, shtëpia kinematografike “B&G Film Production” u vlerësua me 306 pikë;
7. “Platinia i Proletariatit”, regjia A.Ç, shtëpia kinematografike “Saer Production” u vlerësua me 303 pikë
8. “Farat e kujtesës”, regjia M. C, shtëpia kinematografike “Grishaj Film Production”, u vlerësua me 297 pikë;
9. “Nën tokë”, regjia J. C, shtëpia kinematografike “AM-Production” u vlerësua me 283 pikë;
10. “Rënia e Marubit”, regjia A. A, shtëpia kinematografike “Nunu Production” u vlerësua me 273 pikë;
11. “Laurenziana dhe Sinagoga”, regjia Y. P, shtëpia kinematografike “Replay Production” u vlerësua me 225 pikë;
12. “Një udhëtim epik përmes traditës”, shtëpia kinematografike “Lis” u vlerësua me 218 pikë;

³ <https://qkk.al/229307-2/>

13. “Tranzit”, regjia M. J, shtëpia kinematografike “Arsel Films” u vlerësua me 205 pikë;
14. “Legjenda “Moissi”, regjia shtëpia kinematografike “A.R Production” u vlerësua me 197 pikë;
15. “Kristaq Rama-Balt form dhe përjetësi”, regjia M. Sh, shtëpia kinematografike “Shtëpia filmike Cinemania” u vlerësua me 196 pikë;
16. “Gërshëra”, regjia I. D & B. H, shtëpia kinematografike “Production Cinemania” u vlerësua me 195 pikë;
17. “Një europian në oborrin e diktaturës”, regjia E. T, shtëpia kinematografike “MM Nositi” u vlerësua me 186 pikë;
18. “Fëmijët e humbur”, regjia L. Xh & R. J, shtëpia kinematografike “Makers Production” u vlerësua me 179 pikë;
19. “Perde pa dritare”, regjia Y. Gj, shtëpia kinematografike “Blackout Productions” u vlerësua me 178 pikë;
20. “Fluturimi i dritës”, regjia B. G, shtëpia kinematografike “Lissus Media” u vlerësua me 169 pikë;
21. “Ish Tirana”, regjia G. B, shtëpia kinematografike “d’ART Production” u vlerësua me 159 pikë;
22. “Ti Shqipëri më jep nder”, regjia N. P, shtëpia kinematografike “Red Cut Studio” u vlerësua me 142 pikë;
23. “Mos hesht”, regjia M. S, shtëpia kinematografike “Open Vision” u vlerësua me 139 pikë;
24. “Njeriu i ri”, regjia D. H, shtëpia kinematografike “Filma Filma Filma” u vlerësua me 135 pikë;
25. “Shijet e kujtesës - një udhëtim shqiptar”, regjia K. S, shtëpia kinematografike “FILMLIGHT” u vlerësua me 123 pikë.

Sikurse evidentohet më lart, kanë aplikuar gjithsej 25 aplikantë, nga të cilët, pas shqyrtimit të projekteve të paraqitura prej tyre, Komisioni i Miratimit të Projekteve, ka shpallur 10 projektet fituese për Film Dokumentar, duke pasqyruar edhe vlerën përkatëse në lekë, për secilin prej tyre respektivisht, si më poshtë citohen:

1. “Tej maleve të kaltër është deti”, regjia Eneos Çarka, shtëpia kinematografike “Artalb Film Productions” me vlerë totale 2,500,000 (dy milion e pesëqind mijë) Lekë;
2. “Përballë malit”, regjia Ilir Butka, shtëpia kinematografike “Ska-Ndal me vlerë totale 2,500,000 (dy milion e pesëqind mijë) Lekë;
3. “Regjisori përtej sistemeve-Vladimir Prifti për njeriun”, regjia Eliodor Markja, shtëpia kinematografike “EUROFILM” me vlerë totale 2,500,000 (dy milion e pesëqind mijë) Lekë;
4. “Gjiganti i fjetur”, regjia Benart Laze, shtëpia kinematografike “Filter Film” me vlerë totale 2,000,000 (dy milion) Lekë;

5. “Tre jetë në një”, regjia V. L, shtëpia kinematografike “Vasjan Lami” 2,000,000 (dy milion) Lekë;
6. “Tomorr”, regjia A. S, shtëpia kinematografike “B&G Film Production” me vlerë totale 2,000,000 (dy milion) Lekë;
7. “Platinia i Proletariatit”, regjia A. Ç, shtëpia kinematografike “Saer Production” me vlerë totale 1,500,000;
8. “Farat e kujtesës”, regjia M. C, shtëpia kinematografike “Grishaj Film Production” me vlerë totale 2,000,000 (dy milion) lekë;
9. “Nën tokë”, regjia J. C, shtëpia kinematografike “AM-Production” me vlerë totale 2,000,000 (dy milion) lekë;
10. “Rënia e Marubit”, regjia A. A, shtëpia kinematografike “Nunu Production” me vlerë totale 1,800,000 (një milion e tetëqind mijë) Lekë.

Ligji nr. 8096, datë 21.03.1996 “Për Kinematografinë”, i ndryshuar, në nenin 3, ka parashikuar se: *“Qendra Kombëtare e Kinematografisë vepron si person juridik, publik, me statusin e institucionit qendror, në varësi të Ministrisë të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për bashkërendimin e punës, mbështetjen financiare, nxitjen e veprimtarisë kinematografike në Republikën e Shqipërisë dhe për përfaqësimin e kinematografisë shqiptare në botë.*

Statuti i Qendrës Kombëtare të Kinematografisë miratohet nga Këshilli i Ministrave me propozimin e Ministrisë të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Rregullorja e funksionimit të QKK-së miratohet nga Kryetari i kësaj Qendre”.

Në nenin 4 të këtij ligji përcaktohet se: *“QKK ka këto detyra kryesore: 1. 2. Shpërndan fondin për projektet që përmbushin kërkesat e rregullores për prodhimin dhe shpërndarjen e filmit dhe që kanë vlera cilësore dhe interes kulturor kombëtar, gjithashtu raporton për realizimin e projekteve dhe fondeve të miratuara”,* ndërsa në nenin 13, përcaktohet se: *“Përbërja dhe funksionimi i këshillave miratuese të projekteve e komisionit të vizionimit dhe e komisionit financiar përcaktohen në rregulloren e QKK”.*

Me VKM-në nr. 602, datë 21.08.2003, të ndryshuar, është miratuar Statuti i Qendrës Kombëtare Kinematografike. Në këtë Statut parashikohet se: *“Neni 6 “Këshilli Miratues i Projekteve (KMP)”:*

Këshillat Miratues të Projekteve zgjidhen nga shoqatat e kineastëve. Këshillat Miratues të Projekteve, në të tria gjinitë e filmit (artistik, dokumentar dhe të animuar), vlerësojnë dhe për zgjedhin projektet nga pikëpamja artistike e ekonomike dhe projektet fituese ia paraqesin kryetarit për miratim. Këshillat Miratues të Projekteve drejtohen nga kryetarët e tyre, të cilët zgjidhen prej këshillave përkatës çdo dy vjet. Këshillat Miratues të Projekteve janë organizma jofunksionare...”

Rregullorja e Brendshme e organizimit dhe Funksionimit të QKK me nr. 163, datë 22.05.2024, ka të përcaktuar ndër të tjera se: “Kreu 2, pika B.2.1. Kryetari është organi drejtues i QKK, që emërohet nga Këshilli i Ministrave dhe kryen funksionet dhe detyrat e mëposhtme:

1. Kryetari ka kompetenca të plota për të vepruar në dhe për llogari të QKK-së, sipas përcaktimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi;

2. Kompetencat e Kryetarit përfshijnë, por nuk kufizohen si më poshtë:

- Të kryejë të gjitha veprimet për drejtimin e QKK-së.
- Nxjerr urdhra të brendshëm me qëllim përmbushjen e funksioneve të njohura nga ligji dhe Statuti i QKK-së.
- Merr vendime që lidhen me çështje organizative apo financiare, sipas kritereve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
- Emëron Komisionet dhe Këshillat që ushtrojnë aktivitetin në QKK.”.

Në zbatim të kompetencave ligjore të parashikuara si më sipër, Kryetari i QKK-së ka miratuar “Rregulloren e Organizimit dhe Funksionimit të Këshillit Miratues të Projekteve”, me nr. 459/1 prot., datë 17.09.2025 .

Në pikën 1.1, të Rregullores përcaktohet se: “Qëllimi i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i rregullave të organizimit dhe funksionimit të Këshillit Miratues të Projekteve pranë Qendrës Kombëtare të Kinematografisë, rregullave mbi krijimin dhe funksionimin e Këshillit Miratues të Projekteve, si dhe detyrave përkatëse.”

Neni 2, i Rregullores, “Këshilli Miratues i Projekteve”, përcakton se: “1.Pranë QKK-së krijohet Këshilli Miratues i Projekteve. 2.Këshilli Miratues i Projekteve është organizëm i përkohshëm, jofunksional, jashtë strukturës administrative të QKK-së, i cili formohet me kandidatë të propozuar nga shoqatat e kineastëve të njohura nga QKK-ja. Këshilli Miratues i Projekteve gëzon autonomi të plotë për vlerësimin e projekteve kinematografike. 3.Këshilli Miratues i Projekteve ka mandat ligjor 2-vjeçar....”

Neni 4, i Rregullores, “Funksionimi i KMP”, përcakton se: “1.Detyra kryesore e Këshillit Miratues të Projekteve është vlerësimi i projekteve kinematografike nga pikëpamja artistike, si dhe përzgjedhja e projekteve mbi bazë meritokracie, duke garantuar përzgjedhjen e projekteve kinematografike që sigurojnë cilësinë, interesin kombëtar dhe që janë në përputhje me politikat e Institucionit.

2.Anëtarët e Këshillit Miratues të Projekteve mbajnë përgjegjësi ligjore për çdo vendim që marrin.

.....

10.Këshilli Miratues i Projekteve propozon për miratim tek Kryetari i QKK, projektet më të votuara në bazë të sistemit të votimit me pikë me fletë votimi fizike ose digjitale, të veçantë. Fleta e votimit miratohet me vendim të posaçëm të Kryetarit të QKK-së.”

Përzgjedhja e projekteve nga Këshilli Miratues i Projekteve, bëhet sipas përcaktimeve të nenit 8, të kësaj Rregulloreje, duke përcaktuar se: “Përzgjedhja e projekteve nga Këshilli Miratues të Projekteve kryhen sipas fazave në vijim:

Faza 1–Prezantimi i projektit nga aplikantët (pitching): “Projekti prezantohet nga aplikantët para Këshillit Miratues të Projekteve. Prezantimi zgjat deri në 10 (dhjetë) minuta për secilin projekt dhe zhvillimi i kësaj faze është i detyrueshëm.”

Faza 2–Vlerësimi i projekteve nga anëtarët e Këshillit Miratues të Projekteve: “Gjatë fazës së vlerësimit të projekteve, mund të marrë pjesë Kryetari i QKK-së dhe/ose anëtar e stafit të QKK-së. Në rast se shihet e nevojshme në këtë fazë mund të thërriten specialistë të QKK, për të raportuar rreth çështjeve financiare dhe juridike. Për secilin projekt çdo anëtar i Këshillit Miratues të Projekteve plotëson fletën e votimit (fizike ose dixhitale).”

Faza 3–Votimi i projekteve nga anëtarët e Këshillit Miratues të Projekteve: “Secili anëtar i Këshillit Miratues të Projekteve plotëson individualisht fletën e votimit fizike ose digjitale, për secilin projekt të shqyrtuar, duke shprehur vlerësimin e tij/saj profesional për projektin lidhur me këta elementë kryesor: skenar, regji dhe produksion si dhe duke vlerësuar eksperiencën e producentit dhe autorëve.”

Faza 4–Përzgjedhja e projekteve më të votuara, të cilat i propozohen Kryetarit të QKK: “Dokumenti përfundimtar, vendimi i mbledhjes së Këshillit Miratues të Projekteve, përcakton klasifikimin e projekteve dhe masën e financimit të tyre, bazuar në raportin e vlerësimit të Komisionit Financiar. Në fund vendimi nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Këshillit Miratues të Projekteve.”

Neni 9 “Procesi i votimit”, përcakton se: “1. Anëtari/ja i/e Këshillit Miratues të Projekteve, pasi njihet me projektin e paraqitur për aplikim dhe pas përfundimit të prezantimit të projektit ditën e mbledhjes, plotëson individualisht fletën e votimit fizike ose në rrjet, për secilin projekt të shqyrtuar, duke shprehur vlerësimin e tij/saj profesional për projektin lidhur me këta elementë kryesor: skenar, regji dhe produksion si dhe duke vlerësuar eksperiencën e producentit dhe autorëve. 2. Në përfundim të votimit, fletët e votimit administrohen në praninë e Këshillit Miratues të Projekteve nga juristi i QKK-së, i cili kontrollon dhe verifikon anën formale të plotësimit të fletëve të votimit (plotësimi i secilit komponent të fletës së votimit, nënshkrimi i saj, etj). 3. Në prezencë të anëtarëve të Këshillit Miratues të Projekteve, Përfaqësues të QKK komunikojnë me zë të lartë rezultatet e votimit dhe bazuar në totalin e pikëve të grumbulluara bëhet renditja, nga projekti me pikët maksimale, deri tek projekti me pikët minimale. 4. Anëtarët e Këshillit Miratues të Projekteve nënshkruajnë proces-verbalin dhe vendimin përfundimtar të mbledhjes. 5. Kryetari i QKK, në konsultim me Grupin e Menaxhimit Strategjik të QKK (GMS), vendos për numrin e projekteve që do të përfitojnë mbështetjen financiare. Vendimmarrja bazohet në këto kritere: a. Garancitë e suksesit të projekteve të vlerësuara me pikët më të larta; b. Fondet që QKK-ja ka në dispozicion për financimin e projekteve në konkurim. 6. Këshilli Miratues të Projekteve, në vendimin e tij, krahas titullit dhe të dhënave të secilit projekt, përcakton masën e financimit të tij, bazuar në ekspertizën e bërë nga Komisioni Financiar.

7.Vendimi i Këshillit Miratues të Projekteve dhe Kryetarit të QKK-së publikohen në faqen zyrtare të internetit të QKK-së dhe në Buletinin Zyrtar. 8.Drejtoria e Projekteve ka detyrimin t'i përcjellë producentëve të projekteve të papërzgjedhura, informacion lidhur me: i.Rezultatit e vlersimit; ii.Vlerën e financimit.”

Referuar sa më sipër, evidentohet se:

Këshillat Miratuese të Projekteve, në të tria gjinitë e filmit (artistik, dokumentar dhe të animuar), vlerësojnë dhe përzgjedhin projektet nga pikëpamja artistike e ekonomike dhe projektet fituese ia paraqesin kryetarit për miratim.

Kryetari i Qendrës Kombëtare të Kinematografisë ka të drejtë të rikthejë vendimin e Këshillit Miratues të Projekteve për përzgjedhjen e një projekti, duke dhënë bashkëlidhur arsyet përkatëse. Në rast se projekti rivlerësohet dhe vendimi rimiratohet nga këshilli, ai hyn në fuqi menjëherë.

KMP zgjidhen një herë në çdo 2 vjet. Anëtarët e tyre propozohen nga shoqatat e kineastëve, sipas nenit 8, të ligjit nr. 8096, datë 21.3.1996 “Për Kinematografinë”, i ndryshuar.

Nga publikimi në faqen zyrtare të QKK-së, rezulton se, Këshilli i Miratimit të Projekteve të Filmit Dokumentar, të Animuar dhe Projektet e Ndryshme, ka një përbërje prej 5 (pesë) anëtarësh dhe 1 (një) anëtar rezervë (A. B, A. D, E. H, L. P P. L dhe E. T - anëtar rezervë), dhe ushtron funksionin e tij për periudhën nga data 07.06.2024 deri më dtë 06.06.2026⁴.

Në zbatim të sa më sipër, pas shqyrtimit të projekteve të paraqitura nga 25 aplikantët, Komisioni i Miratimit të Projekteve, ka shpallur 10 projektet fituese për Film Dokumentar, duke pasqyruar edhe vlerën përkatëse në lekë, për secilin prej tyre respektivisht.

Rregullorja parashikon se, çdo kandidat i interesuar, i cili pretendon se i është shkelur, mohuar apo cënuar një e drejtë e ligjshme lidhur me vlerësimin e tij gjatë procedurës apo dhe vetë procedurën e ndjekur, mund të ushtrojë të drejtën e ankimit administrativ sipas parashikimeve të Rregullores sipërcituar.

Lidhur me sa më sipër, ankuesja, në momentin e depozitimit të ankesës pranë KMD-së (*edhe pse i është kërkuar nga KMD, të plotësohet dokumentacioni nëpërmjet e-mailit*), nuk ka depozituar asnjë provë a dokument që të faktojë fillimisht, se ka ankimuar vendimin e KMP-së, lidhur me mospërzgjedhjen e projektit të saj për financim.

Ankuesja ka pretenduar se janë favorizuar kandidatët burra, duke pretenduar për trajtim të pabarabartë të saj si grua, nisur vetëm nga fakti se 10 kandidatët fitues janë të gjithë burra. Ajo

⁴ Informacion i publikuar në faqen zyrtare të QKK-së: <https://qkk.al/keshillat-miratues-te-projekteve/>

nuk ka pretenduar apo dëshmuar për ndonjë veprim konkret të KMP-së, apo ndonjë shkelje procedurale gjatë konkurimit të saj në këtë shpallje për Filmin Dokumentar.

- ***Lidhur me vlerësimin e projekteve kandiduese, të kryer nga KMP-ja, Komisioneri vlerëson se:***

Për shkak të natyrës specifike, teknike, profesionale dhe artistike të këtij Komisioni, nuk zotëron ekspertizën e nevojshme për të vlerësuar objektivisht projektet e përzgjedhura e të miratuara prej tij, duke konsideruar edhe faktin që kjo vendimmarrje është kolegjiale, ku secili anëtar voton bazuar në komponentë të veçantë secilin projekt.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, në bazë të rrethanave të shpjeguara, dokumentacionit të depozituar e pretendimit të subjektit ankues, nuk ka informacion të mjaftueshëm apo provë që të dokumentojë faktin se, KMP-ja, ka realizuar procedurë të parregullt lidhur me projektin e prezantuar prej saj, apo të ketë dalë me një vendimmarrje të pabazuar në ligj.

Në këtë kontekst, KMD, vë në dukje faktin se për shqyrtimin e kësaj ankese nuk ekzistojnë indicie të mjaftueshme për të filluar një procedim administrativ. Në parim, duhet të ekzistojnë fakte dhe prova konkrete që dëshmojnë për trajtim të pabarabartë, si dhe duhet të ketë informacion të mjaftueshëm për të iniciuar një hetim administrativ⁵.

Pretendimi i ankueses se është trajtuar në mënyrë të pabarabartë për shkaqe gjinore, nisur vetëm nga dyshimi apo hamendësimi se të gjithë kandidatët fitues janë burra, është një dyshim i paarsyeshëm dhe i pa mbështetur në ndonjë provë, fakt a rrethanë që provon atë.

Dyshimi i arsyeshëm në procesin administrativ është standardi provues që justifikon nisjen e hetimeve ose marrjen e masave administrative paraprake, i bazuar në shkresa e prova të besueshme.

Dyshimi i arsyeshëm lidhet me një gjendje ku provat e paraqitura (shkresat) krijojnë një bindje të bazuar se një shkelje administrative ka ndodhur ose mund të ndodhë.

Ndryshe nga procesi penal ku kërkohet provim përtej dyshimit të arsyeshëm, në administratë ky standard është më i ulët, por duhet të jetë i dokumentuar dhe jo arbitrar.

Nëse dyshimi i arsyeshëm mungon ose nuk është i bazuar në dokumente (shkresa), vendimmarrja administrative rrezikon të jetë lehtësisht e cenueshme.

Në këtë logjikë arsyetimi, Gjykata Kushtetuese, në Vendim nr. 16 datë 12.03.2024 (V-16/24), të saj, ka mbajtur, ndër të tjera, qëndrimin se, barra e provës në lidhje me shkaqet për diskriminim.....i përket fillimisht palës paditëse, por nëse kjo e fundit paraqet disa fakte, të cilat mbështesin në mënyrë të arsyeshme një prezumim për diskriminim, barra e provës kalon tek i padituri.”

Për sa më sipër, vetëm pretendimi se të gjithë kandidatët burra janë shpallur fitues dhe ankuesja nuk është shpallur fituese për shkak se është grua, pa asnjë fakt, provë a rrethanë konkrete që

⁵ Për analogji citojmë Vendimin nr. 205, datë 22.07.2024, të KMD-së.

ta mbështesë në mënyrë të arsyeshme këtë pretendim, nuk mund të përbëjë indicie apo dyshim të arsyeshëm për prezuminim se kjo diferencë në trajtim ka ndodhur për shkak të qenies së saj grua.

Për sa më sipër, referuar nenit 33/4/ç, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se: “Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj⁶.

- **Lidhur me pretendimin tjetër të ankueses për “...ekzistencën e mundshme të konfliktit të interesit në procesin e vlerësimit, nëse anëtarë të komisionit kanë pasur lidhje profesionale, bashkëpunime të mëparshme apo interesa të tjera me subjektet fituese, në kundërshtim me parimet e paanshmërisë dhe barazisë në shpërndarjen e fondeve publike”:**

Komisioneri vlerëson se, nuk mund t’i nënshtrohet shqyrtimit të mëtejshëm për shkak se nuk bën pjesë në kompetencat e tij.

Ligji nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, në nenin 41, të tij, përcakton se, Autoriteti qendror përgjegjës për zbatimin e këtij ligji është Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave”.

Po në këtë nen, përcaktohet se: “1. Inspektorati i Lartë vihet në lëvizje me kërkesë të institucioneve publike, palëve të interesuara dhe kryesisht me nismën e tij.

2. Autoriteti ose strukturat përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji në institucionet publike janë:

- a) eprorët e zyrtarëve, sipas hierarkisë, brenda një institucioni publik;
- b) drejtoritë, njësitë e burimeve njerëzore apo njësi të ngarkuara a të ngritura posaçërisht, sipas nevojës dhe mundësive të çdo institucioni publik;
- c) institucionet eprorë.”

Sa më sipër, bazuar në nenin 33, pika 4, shkronja “b”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar⁷, Komisioneri arrin në përfundimin se, ky kërkim i paraqitur nga subjekti ankues, nuk mund të pranohet, pasi është e papajtueshme me dispozitat e ligjit dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

- **Lidhur me pretendimin e ankueses se procesi i përzgjedhjes nuk është shoqëruar me publikimin e pikëzimeve, procesverbalëve të KMP-së, etj, Komisioneri vlerëson se:**

⁶ Për analogji shih vendimet: nr. 107, datë 20.06.2023, nr. 122, datë 05.07.2023, nr. 45, datë 03.03.2025, nr. 38, datë 19.02.2026, të KMD-së.

⁷ Neni 33, pika 4/b, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcakton se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: b)është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji”.

Ky kërkim i ankueses, nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj nga KMD, pasi ky pretendim i saj, ka të bëjë me moszbatimin apo shkeljet e dispozitave ligjore të ligjit nr. 119/2014 *“Për të Drejtën e Informimit”*, të ndryshuar, sa i takon pretendimit për njohjen apo marrjen e procesverbalëve të vlerësimit të KMP-së⁸.

Për rrjedhojë, për sa më sipër, ankuesja mund t'i drejtohet institucionit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale⁹, pasi hetimi sa më sipër nuk bën pjesë në kompetencat e KMD-së.

Ndërsa, për pretendimin e ankueses se procesi i përzgjedhjes së projekteve nuk është shoqëruar me publikimin e pikëzimeve, Komisioneri vlerëson se, ky pretendim nuk qëndron dhe se është haptazi i pabazuar. Kjo për faktin se, nga këqyrja e bërë në faqen zyrtare të QKK-së, rezulton se, me datë 10.02.2026, është publikuar shpallja e projekteve fituese për film dokumentar dhe promovim dhe renditja e tyre (në rend zbritës) sipas vlerësimit me pikë (shoqëruar dhe me vlerën në lekë) për secilin projekt/aplikant.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/b/ç, të ligjit nr.10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës me nr. 62 Regj., datë 26.02.2026, të subjektit ankues, A. B, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

⁸ Për analogji shih vendimet: nr.175, datë 05.08.2025, nr. 270, datë 26.11.2025, të KMD-së.

⁹ Sikurse rezulton t'i jetë drejtuar sipas citimeve të saj.